

VALMIRA RAMAJ

PROZA E SHKRIMTARIT FATOS KONGOLI
NË VËSHTRIMIN SINTAKSOR

Hyrje

Letërsia ka qenë që në krye të herës objekt jo vetëm i letrarëve, por edhe i studiuesve të gjuhës, të cilët në shumicën e rasteve rregullat dhe dukuritë gjuhësore i shpjegojnë dhe konkretizojnë me shembuj nga vepra artistike dhe kryesisht në zhanrin e prozës. Pasi vetëm letërsia si art i fjalës, sjell larmishmëri dhe forma gjuhësore të ndryshme. Objekti i këtij punimi është vështrimi sintaksor i prozës së Fatos Kongolit, ku kam marrë për shqyrtim tri romanet e tij si: “Endrra e Damokleut”, Tiranë, 2001, “Karuseli” Tiranë, 2007, si edhe “Bolero ne vilën e pleqve”, Tiranë, 2009.

Fatos Kongoli është tashmë i konfirmuar si një mjeshtër i fjalës shqipe, falë mënyrës së përdorimit të saj, ç’ka përcakton edhe stilin e prozës së tij si një stil mjaft lakonik, ku mjetet gjuhësore i ka përdorur jo në organizimin parësor, por në atë dytësor të figurshëm. Lakonizmi i prozës së tij duket qartë në përdorimin e fjalive të shkurtra, ku spikasin ato me mungesë gjymtyrësh kryesorë por edhe dytësore. Një tjetër veçori e stilit të prozës së Kongolit është edhe veçimi i periudhave lejore dhe shkakore nga fjalia drejtuese dhe kjo sigurisht është përdorur me një efekt të caktuar stilistik që të duket sikur veprimi apo ngjarja mbaron aty, por në fakt ndodh e kundërta sepse kjo shkëputje na rikthen sërish te ai veprim apo ngjarje.

1. Sintaksa e prozës së Kongolit

Kongoli është vlerësuar për një gjuhë me nivel të lartë artistik dhe kjo duket në veçoritë dhe risitë që ka sjellë përmes prozës së tij. Shihet qartë përdorimi i një gjuhe elokuente, ku ndërthuren format e ligjërimit të shkruar me atë të folur, forma të dialogut dhe të monologut si tipare karakteristike të shtjellimit të ngjarjeve. Proza e tij nga ana ndërtimore karakterizohet nga frazat e shkurtra dhe jo ato te gjata si edhe nga shpërbërja e periudhave ose veçimi i tyre. P.sh.: *Kjo ishte një grua e shëndoshë, në moshën kalimtare vartësit e mbiquanin Hipopotam. Për shkak të trupit disproporcional.* [Fjali e nr. shkakore, e vecuar. “**Bolero në vilën e pleqve**”, f. 13.], apo: *Tre vjet pa u parë s’janë pak. Sado banale ajo s’mund ta bënte fajtor, që pas tre vjetësh në vend që ta shihte si shoqen e dikurshme, ai e kishte parë si femër.* [Karuseli, f. 42.]. Pra siç e shohim kemi shkëputje të fjalisë shkakore dhe lejore nga fjalia drejtuese e cila ndahet prej saj me një pauzë të gjatë. Nuk mungojnë te kjo dukuri edhe njësi predikative lidhore-përcaktore, që kur dalin të tilla i sjellin prozës elemente të gjuhës së folur, për shembull: *Qenë mbuluar rreth e përqark burra e gra të moshuara. Që ishin plazhistë të atij turi veror.* Jo rrallë, kjo shkëputje e segmenteve predikative, shfaq

elipsën sintaksore, që e vesh gjuhën me shprehësi të veçantë, për shembull: *Vajza e djem po gajaseshin me njëri-tjetrin, të gjithë nxënës të "Sami Frashëri"* [Le të krahasojmë: *Vajza e djem, që ishin nxënës të shkollës "Sami Frashëri," po gajaseshin me njëri-tjetrin.*]

Mjaft të dendura janë rastet kur një element kallëzuesor përbërës i frazës, të shkëputet e të dalë jashtë saj, edhe kur struktura frazale të mos ketë shumë përbërës, si për shembull: *Në këtë pikëpamje ndonësë nuk u besohej ëndrrave, më shumë se për zonjën Firdus, isha paraqitur në kishë për veten time. Që gruaja të mos më shfaqej nëpër gjumë, e unë të mos zgjohesha me lotët në grykë, midis nënës sime dhe zonjës Firdus, pa e kuptuar nëse vuajtja më vinte nga dhimbja për nënën, për zonjën Firdus apo për të dyja bashkë:* [Bolero ...f. 207].

Te kjo shfaqje, na vjen rasti të risjellim një ide të profesor Mahir Domit, për dukuri të zhvillimit të strukturës sintaksore të gjuhës sonë letrare të sotme [SF, 4/1984], i cili nënvizonte se struktura e gjuhës së shkruar në atë kohë po prirej **drejt parcelizmit a segmentimit** të periudhave ose edhe i fjalive. "Këto, sidomos mënyra e dytë, shkruan Domi, janë elemente të reja që po gjenden gjithmonë e më shumë në gjuhët letrare e sidomos në letërsinë artistike. [SF, 4 /f. 61]. Për parcelizmin, ky sintaksolog shkruan se *ai është një nga mjetet kryesore të stilit të thyer. Kjo mënyrë e organizimit të thënies mund të gjendet në ndonjë rast edhe në gjuhën e folur, me vlerën e diçkaje të shtuar, të shkëputur nga ajo që është thënë më përpara, por, në ditët tona ajo është bërë në gjuhën letrare një mjet sintaksor e stilistikor gjithnjë e më i përdorur.* [SF, 4, /f. 61].

Gjithashtu vëmë re se në pikëpamje të ndërtimit të periudhave se proza e Kongolit karakterizohet nga shpërbërja e frazave të gjata, me të cilën kuptohet qartë se kryesisht periudhat nuk janë më të gjata se 3-4 njësi predikative. Por rrallë në prozën e tij mund të hasim ndonjë periudhë me më shumë njësi predikative, por në përgjithësi dominon periudha e shkurtër, për shembull: *-Martini nuk e kuptoi se kur i dha dorën Albanës ishte skuqur.* [Karuseli, f. 65]. Sigurisht që ky nuk është tipari i vetëm ndërtimor i periudhave, sepse përshkrimet e ngjarjeve, personazheve dhe psikologjisë së tyre bëhen edhe nëpërmjet fjalive ose periudhave sipas parimit, *Fjali drejtuese+Fjali e varur*, me të cilën do të kuptojmë se këto periudha kanë rend të drejtë dhe më rrallë hasim periudha me rend të zhdrejtë, ku fjalia e varur është vendosur para fjalisë drejtuese, ku kjo e fundit të ketë fituar një shprehësi monotone të të treguarit, stilin e shtruar, që është karakteristikë e rrëfimit të ngadalshëm, pa shumë ngjarje të vullshme. Këtë rend më së shumti e hasim te fjalitë e varura kohore¹, ku përgjithësisht dalin para fjalisë drejtuese, për shembull: ***Tek e lyeja, më pyeti nëse kishte ndonjë ënjtje. Nuk më besoi kur iu përgjigja jo, asnjë ënjtje, ishte thjesht punë kockash...***[Bolero, f. 67].

Ashtu sikur fjalitë e varura lejore dhe shkakore të cilat shkëputen me pauzë të gjatë nga periudha, vihet re se kjo ndodh edhe në disa lloje fjalish me bashkërenditje, ku më të dukshmet janë ato me marrëdhënie kundërshtore dhe më pak ato me marrëdhënie përmbyllëse, për shembull: *-Deomos përbindëshi më*

¹Xh. Lloshi, *Stilistika e gjuhës shqipe*, Ribotim, Tiranë, 2005.

Proza e shkrimtarit Fatos Kongoli në vështrimin sintaksor

shembte në dru, në këtë pikë nuk ushqeja iluzione. Por edhe kështu fitoja pikë. [Endrra..., f. 109]. –*Më beso botë tjetër s'ka. Prandaj dal edhe unë me një propzim.* [Bolero, f. 177] etj.

Fatos Kongoli shfrytëzon mjaft mirë mjetet e ndryshme të lidhjeve sintaksore, sidomos të atyre polisemantike, siç janë ndërtimet shkakore me lidhëzat kohore, ndërtimet krahasore me lidhëzat mënyrore, etj. Nga këndvështrimi gjuhësor shihet mjaft qartë se për nga ndërtimi kemi përdorim më të gjerë të periudhave sindete se sa i atyre asindete. Mjaft të pasura në prozën e Kongolit dalin edhe strukturat korrelative, jo vetëm tek periudhat me fjali të varur rrjedhimore, por sidomos, tek ato me fjali të varur vendore e kohore, të cilat u përkasin fjalëve korrelata me topikë tek fjalia drejtuese e frazës, për shembull: *Ishte dimër atëherë kur në vilë u duk një banor i ri.* Ose: *U ndalën në cepin e oborrit me lule, atje ku nuk mund t'i shihnte as t'i dëgjonte njeri.* Shpesh këto modele krijojnë ndërshtënie të tilla që i largojnë aq shumë marrëdhëniet e subjektit me predikatin [S-P], për shembull: *Të dilën në mbrëmje, kur një parandjenjë më tha se atje duhet të kishte filluar festa, u grinda keq me fytyrën time serioze.* [Le të krahasojmë: *Të dilën në mbrëmje u grinda keq me fytyrën time, kur një parandjenjë më tha se atje duhej të kishte filluar festa.*] Ndërsa në rastin e parë lexuesi duhet të sforcohet për gjetjen dhe shfrytëzimin e mjeteve intonative [pauzat, ritmi, melodika etj.], në rastin e dytë këndimi vjen linear, i pa sforcuar, njësoj si në shqiptimin e një fjalie dëftore.

Proza është një tip ligjërimi letrar që vjen nga përpunimi artistik i rrëfimit të gjuhës së gjallë dhe i monologut. Kështu duke qenë një krijim artistik, “vepra letrare në një kuptim të caktuar është edhe një krijim gjuhësor” një eksplorim i mundësive deri atëherë të pashfrytëzuara në atë mënyrë. Shkrimtarët ndikojnë me përdorimin e veçantë të mjeteve, me lidhjet e ndërthurjet e shoqërimit e tjera të fjalëve, me kuptimet dhe ngjyrimet e reja, me sintaksën e shndërruar, me organizimet dytësore që u japin peshë elementëve të veçantë në indin tërësor dhe ngjallin efekte estetike, vlerësimin e anës tingullore, të ritmit, të lidhjeve të papritura, të formës së brendshme, të aftësisë së figurshme e simbolizuese e deri lojës gjuhësore. Gjithashtu shkrimtarët interesohen drejtpërdrejt për format ligjërimore, për funksionet e tyre shoqërore-kulturore, për aftësinë e tyre karakterizuese dhe për mjaft aspekte të tjera të përdorimit të gjuhës së gjallë. Nga kjo pikëpamje shkrimtarët janë “gjuhëtarë të një tipi të veçantë, vëzhgues dhe regjistruar të gjuhës”. Në këto tri romane përshkrimin e ngjarjeve, situatave e personazheve, autori e realizon nëpërmjet alternimit të strukturave, të atyre me parataksë me ato me hipotaksë, por edhe modele të lidhjes lineare. Pra shohim që në një farë mënyre proza e Kongolit vjen si një alternativim i strukturave sindete me ato asinde dhe i strukturave me rend të drejtë me ato me rend të zhdrejtë, ku përkatësisht dominojnë strukturat sindete dhe strukturat me rend të drejtë. Gjatë leximit të romaneve nuk mund të mos e vëmë re reticencën, ku fjalia nuk vazhdon me fjalë por në vend të tyre vendosen tri pika (...) që të lënë të kuptosh se veprimi vazhdon.

Roli i ndërtimeve sintaksore për paraqitjen e situatave, ngjarjeve dhe psikologjisë së personazheve.

“Pranimi i organizimit si thelbi i stilit do të thotë se sintaksa është përçuese e stilit, është mbështetje e ndërtimeve me domethënie e ngjyime plotësuese. Natyrisht dukuritë sintaksore marrin pjesë së bashku për të përfutur shprehësinë. Kështu si elemente sintaksore që marrin pjesë për paraqitjen e situatave, ngjarjeve, dhe psikologjisë mund të përfshijmë, gjymtyrët përbërës të fjalisë, vendin që zënë këta gjymtyrë, mjetet e lidhjes, si edhe tipat dhe kuptimet e fjalisë. Çdo tip fjalie në gjuhën shqipe ka gjymtyrë të domosdoshme dhe një numër mesatar të gjymtyrëve të dyta. Por për arsye të ndryshme stilistike e shprehëse kemi edhe luhajtje të këtyre gjymtyrëve si: elipsa me të cilën kuptojmë mungesë të gjymtyrëve, e cila përdoret nga shkrimtarët për të dhënë ngjyime të ndryshme bisedore, sepse ajo rrit tempin e shtjellimit të ngjarjeve, nëse mënjanojnë kryefjalët e fjalive apo kallëzuesit e tyre. Dhe kjo dukuri nuk i ka shpëtuar as penës së Kongolit në prozën e vet, i cili e ka shfrytëzuar më së miri për paraqitjen e situatave dhe marrëdhëniet mes personazheve, dhe kryesisht mes dialogëve të tyre, për shembull:

- *Të dy e ndienin se shoku e pergjonte.*
 - *Po ikën nesër?-u dëgjua më në fund zëri i të voglit.*
 - *Do iki,-u përgjigj i madhi.*
 - *tri javë?*
 - *Tri javë.*
 - *Ku kësaj rashe?*
 - *Rrëzë Korabit.*
- [Karuseli, f. 128].

Ndërsa tepria e gjymtyrëve shfaqet kryesisht si përsëritje tyre, dhe në prozën e Kongolit ka një përdorim të dendur të kësaj dukurie sintaksore e stilistike pasi autori e përdor për të sjellë te lexuesi theksim, përforsim, apo kundërvënie, por edhe për të dhënë gjendje psikologjike. Po nga ana tjetër përsëritja karakterizon tipin e ligjëritimit, prandaj edhe shkrimtari e shfrytëzon për humor, për të dhënë thjeshtësinë të folurit të personazhit deri te mungesa e aftësisë për të rrëfyer. Të gjitha këto varen nga llojet e mjeteve fonetike, morfologjike, leksikore e semantike që vihen në veprim gjatë përsëritjes. Përsëritja sintaksore ndërthuret me përftesa, fonetike, dhe në prozë ky lloj organizimi e ndan prozën në masa muzikore². Si elipsa ashtu edhe tepria e gjymtyrëve shihen si përftesa të veçanta në sintaksostilistikë. Gjithashtu një peshë të madhe dhe shumë të rëndësishme të ndërtimeve sintaksore në prozën e tij luajnë edhe tipat e fjalive. Vihet re se ai është një mjeshtër i madh i përdorimit të fjalive të shkurtra. Fraza e shkurtër përdoret prej tij për të nxitur vëmendje, për të dhënë rrjedhën e shpejtë të ngjarjeve, aq sa mendimi nuk e ndjek dot gjuhën. Po ashtu vihet re se autori përdor pothuaj të gjitha llojet e fjalive si pyetëse, nxitëse, urdhërore, e dëftore, për karakterizimin e situatave e ngjarjeve. Për ndërtimin e fjalive apo të periudhave

² Xh. Lloshi, *Stilistika e gjuhës shqipe*, Ribotim, Tiranë, 2005.

Proza e shkrimtarit Fatos Kongoli në vështrimin sintaksor

shfrytëzohet prej autorit përdorimi i foljeve kallëzues pothuaj më shumë në mënyrën dëftore, dhe atë lidhore. Ndërsa në periudhat me fjali të nënrenditura kushtore kemi gjetur shpjegimin e prof. Çabejt që fraza të tilla me strukturë dy përbërës kallëzuesor e kanë burimin të fjalitë pyetëse, gjykim që del i kuptueshëm duke u mbështetur tek intonacioni i tyre dhe pauzat e mesme e të gjata. Kjo e dhënë na vjen nga përmbledhja e ligjëratave të tij, me titull “Hyrje në indoevropianistikë”, ose Leksionet e Prishtinës. Ky gjuhëtar i shqipes tregon se duhet kërkuar nga gjuha e folur, e pikërisht nga fjalitë pyetëse të drejtpërdrejta për të gjetur fillimin e strukturave të periudhave me fjali të varura kushtore, si: *Ngordhi dhia? U prish tagjia*. Krahasonjmë: Po ngordhi dhia, u prish tagjia. Kështu mund të themi se duke shfrytëzuar të gjitha këto mjete që të ofron gjuha, Fatos Kongoli ka sjellë një prozë mjaft të arrirë artistikisht dhe gjuhësisht.

BIBLIOGRAFI

- E. Çabej, *Hyrje në indoevropianistikë*, Leksionet e Prishtinës, Tiranë, 2008, f. 228-229.
Gramatika e gjuhës shqipe 2, Sintaksa e periudhës, Akademia e Shkencave 2002.
M. Domi, *Dukuri të zhvillimit të strukturës sintaksore të gjuhës sonë letrare të sotme*, SF, 1984, f. 61-62.
T. Topalli, *Ligjëratat në kursin njëvjeçar të Sintaksës shqipe*, 2007-2008.
Xh. Lloshi, *Sintaksostilistika*.
Xh. Lloshi, *Stilistika e gjuhës shqipe*, 2005.

